



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2024:059884

Datë: 08.01.2025

Numri i dokumentit: 06687762

P.nr. 154/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, me Gjyqtaren e vetme gjykuese Blerta Kelmendi, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Leonita Lajqi-Muçaj, në çështjen penale ndaj të pandehurit H.Z, nga fshati, i komunës së, për shkak të veprës penale “*Vjedhja*” nga neni 313 paragrafi.1 i KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, nën shenjën PP/II.nr.141/2024 të datës 21.02.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 23.12.2024, në prezencën e Prokurores së Shtetit Lumturije Hoxha, të pandehurit H.Z, me datën 24.12.2024, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datën 08.01.2025, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

H.Z, i lindur më datë, në, Rr. “.....” në fshatin, në komunën e, ku edhe tani banon, nga babai S. dhe nëna S2., i vajzërisë, beqar, ka të përfunduar shkollën e mesme, i gjendjes ekonomike të ulët, i identifikuar me numër personal ID-....., i nacionalitetit Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, **mbrohet në liri**.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

-Me dt. 02.12.2021 në kohë të papërcaktuar, pikërisht në ambientet e brendshme të Qendrës Tregtare me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete, tjetrit ia merre pasurinë e luajtshme – kablllo elektrike, këtu të dëmtuarës, në atë mënyrë që i pandehuri duke shfrytëzuar momentin e volitshëm, derisa ishte duke punuar si punëtorë në kompaninë “.....”, në ambientet e brendshme të Qendrës Tregtare, merre një sasi të kablllove elektrike me dimensione të ndryshme, ngjyrë të zezë, të cilat i vendos në automjetin e tij të markës, me targa dhe rrugës me qëllim që të njëjtat t’i pastron për të nxjerrë bakrin është hasur nga policia në fshatin, Komuna e Istogut ku edhe është arrestuar, me ç ‘rast të dëmtuarës i shkakton dëm të konsiderueshëm material.

- Me çka ka kryer veprën penale “*Vjedhja*” nga neni 313 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në mbështetje të nenit 1, 4, 7, 8, 9, 17, 21,31, 38, 39, 40, 42,43, 69, 70, 71, 72, 76, si dhe nenit 313 par.1 të KPRK-së, si dhe neneve 242, 277, 364, 449, 450, 452 dhe 460 të KPPRK-së, të akuzuarin e:

GJYKON

- I.** Me **DËNIM ME BURGIM**, në kohëzgjatje prej një (1) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri gjatë periudhës së verifikimit prej dy (2) vitesh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen veprë tjetër penale.
- II.** Si dhe **DËNIM ME GJOBË**, në shumën prej shtatëqind (700) euro, e të cilin dënim i njëjti obligohet ta paguajë në afat prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- III.** Nëse i pandehuri, dënimin e shqiptuar në të holla dështon, refuzon apo nuk mund të paguajë, gjykata dënimin me gjobë në bazë të nenit 43 par. 3, të KPRK-së, do t'ia zëvendësojë me dënim me burg, ku një (1) ditë burgim do të llogaritet me njëzetë (20) euro gjobë.
- IV.** Nëse i njëjti nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën në tërësi, gjykata do ta zëvendësojë pjesën e mbetur të gjobës me dënim me burgim. Nëse i njëjti e paguan pjesën e mbetur të gjobës, ekzekutimi i dënimit me burgim ndërpritet.
- V.** Obligohen i pandehuri që gjykatës të i' a paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej nga tridhjetë (30) euro si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit të paguajnë shumën prej nga njëzetë (20) euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.
- VI.** Pala e dëmtuar: Përfaqësuesi juridik i Qendrës Tregtare “.....”, me seli në Pejë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, me datën 21.02.2024, ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.141/24, kundër të pandehurit H.Z, nga Istogu, për shkak të veprës penale “Vjedhja” nga neni 313 paragrafi 1 i KPRK-së.

Gjykata me datën 23.12.2024, ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar në këtë çështje penale, në të cilën konform dispozitës së nenit 240 të KPPRK-së, kanë qenë prezentë Prokurori i Shtetit Lumturije Hoxha dhe i pandehuri H.Z.

Në këtë seancë, pasi që gjykata të pandehurit i ka komunikuar të drejtat dhe detyrimet e tij që i takojnë në procedurën penale sipas KPPRK-së, ashtu që i pandehuri ka deklaruar se i ka kuptuar këto të drejta, ashtu që i pandehuri H.Z, deklaroi se mbrojtjen dëshiron të e jap personalisht.

Pas leximit të aktakuzës PP/II.nr.141/24 të datës 21.02.2024, dhe gjykata më pas i ka udhëzuar të pandehurin për kushtet, benefitet dhe pasojat e pranimit apo mospranimit të fajësisë, dhe pasi që është bindur se i pandehuri ka kuptuar këto të njëjtit i ka dhënë mundësinë që të deklarohet për pranimin ose mos pranimin e fajësisë.

Në këtë rast i pandehuri H.Z, ka deklaruar se i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e fajësisë dhe në mënyrë vullnetare dhe me vetëdije e pranon fajësinë, për veprën penale e cila i vihet në barrë, respektivisht për veprën penale “Vjedhja” nga neni 313 paragrafi 1 i KPRK-së, ashtu siç ekziston në përmbajtje të aktakuzës pa asnjë ndryshim.

Lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, Prokurorja e Shtetit Lumturije Hoxha ka deklaruar se: *pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, pasi që i plotëson kushtet dhe ka mbështetje në provat materiale.*

Në vijim, gjykata ka shqyrtuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në raport me dispozitën ligjore të nenit 242 par. 2 nën par. 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4 të KPPRK-së, dhe gjeti se në rastin konkret të gjitha këto kushte janë përmbushur në mënyrë kumulative.

Kjo për faktin se gjykata ka gjetur se i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, një pranim i tillë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të të akuzuarit, pranimi i fajësisë nga ana e tij po ashtu gjen mbështetje edhe në provat materiale siç janë: *Raporti i Oficerit E. I. KPS 10744 me nr. 2021-DA-2123 i dt. 03.12.2021, Raporti i Oficerit N. H. PK 7262, Raporti i Oficerit S.M. PK 0283, Raporti i Oficerit A.M. #3375, Deklaratën e dëshmitarit të dhënë në Stacionin policor në Istog me datë 03.12.2021, Deklaratën e dëshmitarit I.Z. të dhënë në Stacionin policor në Istog me datë 02.12.2021, Deklaratën e të pandehurit Hashim Zenuni të dhënë në Stacionin policor në Istog me datë 02.12.2021, Vërtetim mbi Sekuestrimin e Automjetit me nr.2021-DA-2123 të dt.02.12.2021, Vërtetim mbi Sekuestrimin e Përkohshëm të Sendeve me nr.2021-DA-2123 të dt.02.12.2021, Vërtetim mbi kthimin e Sendeve të Sekuestruara Përkohësisht me nr.2021-DA-2123 të dt.02.12.2021, fotografitë nga vendi i ngjarjes, po ashtu, gjykata ka gjetur se aktakuza në fjalë nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, ashtu që konform dispozitës së nenit 242 par.6 të KPPRK-së, ka miratuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.*

Pasi që palët njëzëri kanë deklaruar se nuk propozojnë që të caktohet seanca e posaçme për matjen e dënimit e paraparë me nenin 356 par.1 të KPPRK-së, gjykata ka vazhduar seancën me shqiptimin e dënimit duke i ftuar palët që të deklarohen lidhur me rrethanat rënduese dhe lehtësuese.

Prokurorja e Shtetit Lumturije Hoxha, ka deklaruar se: *i propozoj gjykatës që në kuptimin e rrethanave rënduese të marrë parasysh ndonjë dënim të mëparshëm të të pandehurit, ndërkaq si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë.*

I pandehuri H.Z, ka deklaruar se: *jam penduar për veprën penale të cilën e kam kryer, i premtoj gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, palës së dëmtuar ia kam kthyer sendet të cilat i kam marr, lus gjykatën që të më shqiptojë një dënim sa më të butë.*

Prandaj, me faktet e ofruara në shkresat e lëndës, e po ashtu me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Nga gjendja e vërtetuar faktike siç është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, rrjedh se në veprimet e të pandehurit H.Z, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale “Vjedhja” nga neni 313 paragrafi 1 i KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se të i pandehuri ka ekzistuar dashja që vepra penale të kryhet në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për veprimet e kryera dhe e ka dëshiruar kryerjen e saj.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, Gjyqtarja e vetme gjykyese në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, i vlerësoi rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit ashtu që si rrethanë posaçërisht lehtësuese për të pandehurin H.Z, mori faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë që në shqyrtimin fillestar, pastaj si rrethana lehtësuese mori edhe shprehjen e pendimit dhe keqardhjes për veprën e kryer penale, kurse si rrethanë rënduese mori faktin se i pandehuri është i dënuar edhe me parë me Aktgjykim të formës së prerë të datës 24.05.2024, nën shenjë P.nr.317/2022, për vepër penale “Vjedhja e rëndë” nga nenin 315 i KPRK-së, me të cilin është dënuar me dënim me kusht.

Andaj, gjykata në bazë të rrethanave të lartë-theksuara, të akuzuarit i shqiptoi dënimin sikurse u theksua në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke ardhur në përfundim se me këtë dënime të shqiptuar, do të arrihet efekti preventiv i dënimit, respektivisht që në të ardhmen të përmbahet nga këto veprime/kryerja e veprës-veprave penale të këtilla.

Gjykata në rastin konkret ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e këtu të pandehurit, i cili do ta kuptoj rëndësinë e veprës penale të cilën e ka kryer dhe në këtë mënyrë i njëjti do të reflektoj që në të ardhmen mos të kryejë veprime të ndaluara - përkatësisht mos të kryej vepër penale, si dhe do të ndikoj tek personat tjerë të mos kryejnë vepra penale, të shprehë gjykimin shoqëror për veprat e kryera penale, të bëj ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit konform nenit 38 të KPRK-së.

Dënueshmeria e veprës penale “Vjedhje” nga neni 313 par.1 i KPRK-së, me të cilën ngarkohet i pandehuri, përcaktohet me dënim me gjobë dhe me burgim deri në 3 vite, “Kushdo që personit tjetër ia merr pasurinë e cila vlerësohet në shumën prej pesëdhjetë (50) Euro apo më shumë, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo për personin tjetër, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet”, andaj gjykata me rastin e vendosjes ka zbatuar dispozitën e nenit 43 par.1 të KPRK-së “Dënimi me gjobë nuk mund të jetë më pak se njëqind (100) Euro evropiane (në tekstin e mëtejshëm “EURO”). Dënimi me gjobë nuk mund të tejkalojë njëzet e pesëmijë (25.000) Euro, ndërsa për veprat penale lidhur me terrorizëm, organizuar ose veprat penale të kryera me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore nuk mund të tejkalojë pesëqind mijë (500.000) Euro”.

Si dhe nenin 49 par.1 të KPRK-së: “Dënimi me kusht mund t’i shqiptohet kryesit të veprës penale për të cilën me ligj është paraparë dënimi me burgim deri në pesë (5) vjet”, dhe par. 4 “Me rastin e marrjes së vendimit për shqiptimin e dënimit me kusht, gjykata merr posaçërisht parasysh qëllimin e dënimit me kusht, sjelljen e mëparshme të kryesit, sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrethanat e tjera në të cilat është kryer vepra penale”, ndërkaq në përputhje me paragrafin 5 të këtij nenin të pandehurit i ka shqiptuar dënim me gjobë i cili do të ekzekutohet brenda afatit të përcaktuar në dispozitiv, ndërkaq për dënimin e shqiptuar me burgim ka përcaktuar dënim të kushtëzuar i cili nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër të re penale brenda periudhës së verifikimit të përcaktuar si në dispozitiv të aktgjykimit, par.4 i nenit 49 shprehimisht përcakton se: “Kur gjykata shqipton dënimin me burgim dhe dënimin me gjobë, gjykata mund të shqiptojë dënimin me kusht për të dy këto dënime ose vetëm për dënimin me burgim”, andaj gjykata ka shqiptuar dënim të kushtëzuar me burgim dhe dënim me gjobë.

Përcaktimi i dënimit me burgim të kushtëzuar në kohëzgjatje prej 10 muajsh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në periudhë verifikuese prej 2 viteve për të pandehurin u bë duke e filluar matjen e dënimit nga pikënisja e dënimit e pastaj, duke vlerësuar rrethanat rënduese dhe lehtësuese të rastit, duke bërë peshimin e tyre si dhe duke aplikuar dispozitat ligjore përkatëse për matjen e dënimit, gjykata vendosi për dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi lidhur me revokimin e dënimit me kusht nëse i pandehuri kryen vepër tjetër penale brenda periudhës së verifikimit është marrë konform nenit 50 të KPRK-së. Vendimi për zëvendësimin e dënimit me gjobë me dënim burgimi në rast së i pandehuri dështon, refuzon apo nuk mund të paguajë dënimin e shqiptuar me gjobë, është marrë konform nenit 43 par.3 të KPRK-së.

Gjykata duke vendosur lidhur me shpenzimet e procedurës, në kuptim të nenit 449 par.1 dhe par. 2 dhe nenit 452 par. 1 të KPRK-së, i ngarkoi të pandehurit secilin veç e veç lidhur me për shpenzimet e procedurës, të precizuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke u bazuar në shpenzimet që janë shkaktuar prej fillimit të kësaj procedure e deri në përfundimin e saj, e po ashtu konform nenit 36 par.1, 2, 3, nën par. 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimin, gjykata të pandehurin e obligoi në pagesën e taksës për kompensimin e viktimave të krimin, si në

dispozitiv të këtij aktgjykimi, të cilat obligohet ti paguajë në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Konform nenit 462 të KPRK-së, pala i dëmtuar përfaqësuesi juridik i Qendrës Tregtare “.....”, me seli në Pejë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike u udhëzua në kontest të rregullt juridiko – civil, andaj gjykata ka vendosur si në pikën e VI të dispozitivit të këtij aktgjykimit.

Andaj, nga të lartcekurat, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 364 të KPPRK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL
P.nr.154/24, me datë 08.01.2025.

Bashkëpunëtore profesionale:

Gjyqtarja e vetme gjykuese:

Leonita Lajqi Muçaj

Blerta KERMENDI

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.